



Durrës më 26/09/2018

KLINIKA E LIGJIT UAMD

Kërkues:

Objekti: **Kërkesë për marrjen e masave lidhur me vendgrumbullimin e mbetjeve në Porto Romano**

Drejtuar: **Bashkisë Durrës**

Për dijeni: **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**
Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Baza ligjore: Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji Nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligji Nr.44/2015, Kodi i Procedurave Administrative; Ligji Nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”; VKM 452, dt.11.07.2012. “Për lëndfilllet e mbetjeve”.

Të nderuar Zotërinj,

Klinika e Ligjit UAMD, është një strukturë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, e cila ofron shërbimin e ndihmës ligjore pa pagesë, në çështje me interes të posaçëm për komunitetin e Durrësit.

Në kushtet kur problemi i lëndfillit të mbetjeve në Porto Romano, në Spitalë, është bërë shqetësues për një grup banorësh të zonës dhe studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, po ju drejtohem me këtë kërkesë, e cila synon t’ju kërkojë marrjen e masave konkrete për menaxhimin e veprimtarisë ndotëse të kësaj lëndfilli, deri në mbylljen përfundimtare të tij, për shkak të gjendjes faktike në të cilën ai po operon.

Bashkia e Durrësit është Autoriteti kryesor përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në Durrës dhe ajo i kryen këto shërbime nëpërmjet dy Ndërmarrjeve të saj të Shërbimeve Komunale: 1) Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh. Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 23 (10), përcakton ndër të tjera se: Bashkia ka përgjegjësi: “*Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake*”. Po ashtu ligji Nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 21 (12), përcakton se: “*Kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.*”

Nga ana e Bashkisë Durrës është miratuar në Maj të vitit 2010, Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Durrës 2010 -2025. Ky plan, ndër të tjera analizon situatën në këtë vendgrumbullim dhe konstaton problematikat e theksuara. Sipas këtij plani, ky vendgrumbullim do të mbyllet në vitin 2015. Në vijim të kërkesës do të ndalemi tek disa prej aspekteve më kryesore, të evidentuara në këtë plan, i miratuar nga vetë ju, si institucion.

“Vendhedhja e Porto Romanos është funksionale që prej vitit 1994 dhe ndodhet në zonën industriale, 4-5 km në Veri të Durrësit. Vendhedhja është organizuar në 3 parcela dhe mbulon një sipërfaqe prej rreth 200,000 m². ... Vendhedhja e Porto Romanos është e vetmja vendhedhje për zonën e Durrësit dhe e gjithë sasia e mbetjeve bashkiake të pa ndara, një përzierje e mbetjeve të rrezikshme me mbetjet e parrezikshme, **mbetjet spitalore dhe mbetjet industriale** së bashku me mbetjet inerte, përfundojnë në këtë vendhedhje, duke mos ndjekur asnjë standart mjedisor .

Vendhedhja ka një jetë të mbetur prej 5 vjetësh, por është më mirë të braktiset e mbyllet siç duhet dhe të ndërtohet një lëndfill i ri në territorin e Durrësit, ose të përdoret një lëndfill i përbashkët / rajonal në një zonë tjetër. ... Performanca mjedisore e vendhedhjes është **katastrofike** për shkak të çdo aspekti të emetimeve potenciale. Vendhedhja vuan nga ndotja e mbetjeve, lëngjet që rrjedhin nga lëndfilli në ujrat nëntokësorë dhe në det, emetimet e pakontrolluara të biogazrave, e gjithashtu **vendi merr flakë rregullisht** në kohë të thatë, duke **shkarkuar përqëndrime të larta të dioksinave dhe furaneve**.

Risqet më të mëdha në lidhje me mjedisin, shëndetin e njerëzve dhe sigurinë janë si më poshtë vijojnë:

1. Ndotja e tokës dhe e sipërfaqes rrezikon florën dhe faunën në ligatina;
2. Problemet e higjienës mund të shkaktojnë sëmundje tek gjermuesit e mbetjeve, stafi, shpërndarësit privatë të mbetjeve, dhe te vizitorët e padëshiruar.
3. Risqet për shëndetin nga zinxhiri ushqimor (kafshë shtëpiake të infektuara) dhe kafshë të tjera (qen, zogj);
4. Tymi nga zjarret në lëndfill mund të jetë i rrezikshëm si rezultat i dioksinave dhe përmbajtjes së ndotësve të tjerë.

Vendhedhja e Porto Romanos **nuk ka**:

1. shtresë mbrojtëse për ujin për të shmangur penetrimin nëntokësor të lëngjeve që rrjedhin në lëndfill;
2. barriera kufitare;
3. sistem grumbullimi për infiltrimin e mbetjeve;
4. impiant të grumbullimit të ujrave sipërfaqësorë (për ujin nga shiu);
5. rrjet për të mbledhur biogazrat;
6. mbulim ditor të mbetjeve për të shmangur erërat dhe djegien e mbetjeve;
7. rrjet rrugësh të brendshme;
8. zyra në vendhedhje;
9. impiant për ndarjen manuale të mbetjeve. Gjermuesit e mbetjeve qëndrojnë në majë të mbetjeve për të ndarë rrymat e mbetjeve që ju interesojnë;
10. rrethim me gardh të fushës;
11. akses të kontrolluar;
12. sistem peshimi;”

Kjo analizë është bërë nga ana e Bashkisë Durrës 8 vjet më parë dhe situata sot, 3 vjet, pas kalimit të afatit të përcaktuar për mbylljen e vendgrumbullimit të mbetjeve,

është edhe më e rëndë. Kjo situatë është përkeqësuar nga fakti, se përveç banorëve të zonave përreth, në prani të vedngrumbullimit, është ndërtuar edhe Korpusi Universitar, ku aktualisht bëjnë mësim mbi 10 mijë studentë. Në gjithë këto vite, nga ana e Bashkisë Durrës, nuk është marrë asnjë masë që do të sillte në mos mbylljen e lëndës, të paktën një ulje të ndotjes së shkaktuar prej tij.

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, me shkresën Nr.1260/1, datë 10.10.2018, na informon se ka kryer një studim për gjendjen e zonës së fushës së mbetjeve në Porto Romano, dhe konstaton se situata: **“paraqitet në një gjendje ekstremisht të degraduar në pikëpamje ambjentale”**. Në pikën 1.3 të këtij studimi, rezultojnë: **“Performanca mjedisore e vendndëgjës është katastrofike, për shkak të çdo aspekti të emetimit potenciale... e gjithashtu vendi merret flakë rregullisht”**.

Ligji Nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 5 të tij, përcakton se: **“Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit Mbetjet menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos: a) duke mos vënë në rrezik ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët; b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë; c) duke mos shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore.”**

Siç me të drejtë konstatohet nga ana e studimit të mësipërm, por edhe nga studimi i kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, i cili na është vënë në dispozicion me shkresën Nr.1260/1, datë 10.10.2018, vengrumbullimi i nënshtruhet vazhdimisht zjarreve. Neni 61, pika ç) e ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, parashikon se: **djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me këtë ligj.**

Bashkia Durrës duhet të vepronte lidhur me vendgrumbullimin e mbetjeve në Porto Romano dhe për menaxhimin e mbetjeve në qytetin e Durrësit në tërësi. Konkretisht, ka pasur detyrimin që në bazë të VKM nr.452/2012, pavarësisht nëse kishte apo jo leje mjedisore, të merrte masa për të hartuar një plan përmirësimi të lëndës dhe ta paraqiste atë pranë AKM-së. Një tjetër detyrim i Bashkisë Durrës, në zbatim të nenit 18, të ligjit 10463/2011, ka qenë marrja e masave që brenda 31 dhjetorit të vitit 2018, të realizohej grumbullimi i diferencuar i mbetjeve. Një tjetër detyrim ligjor, i cili nuk është përmbushur nga ana e Bashkisë.

Zona në fjalë nuk ka Leje Mjedisore, dhe ky fakt na është konfirmuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me shkresën e tyre me nr.2857/1 Prot., datë 02.10.2018.

Me Vendimin nr.533, datë 10.07.2018, Këshilli Bashkiak Durrës, ka vendosur: **“Të kërkojë pranë Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, shpalljen e emergjencës Mjedisore në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në territorin e Bashkisë Durrës.”**. Nga informacioni mediatik, rezultojnë se në datë 29.10.2018, Komiteti ka vendosur që të miratojë këtë kërkesë të Këshillit Bashkiak dhe të marrë vendim për shpalljen e gjendjes së Emergjencës Mjedisore.

Pranë zonës së mbetjeve në Porto Romano banon një numër i konsiderueshëm qytetarësh të Durrësit, banorë të Spitallit dhe të Porto Romanos. Ndikimi negativ tek njerëzit i zonës është shumëfishuar nga momenti, kur në qershor të vitit 2011, u miratua

leja për ndërtimin e Kampusit Universitar, në një sipërfaqe prej 55 ha, në zonën e Spitallës, vetëm 1km larg vendgrumbullimit të mbetjeve.

Asnjë prej veprimeve të mësipërme, nuk i heq Bashkisë Durrës kompetencën për të vepruar për menaxhimin e vendgrumbullimit të Porto Romanos.

Prandaj, nisur nga sa më sipër, kwrkojmw nga ana juaj:

- Të ndalohet menjëherë, hedhja e mëtejshme e mbetjeve në këtë vendgrumbullim.
- Bashkia Durrës, duhet ta mbajë në monitorim të vazhdueshëm për të ndaluar ndezjen e qëllimshme të zjarreve, si dhe të shuajë zjarret në rastet kur ato ndodhin;
- Të merren masa për mbulimin me dhe të mbetjeve ekzistuese.
- Të merren masa për rrethimin e përkohshëm të vendgrumbullimit për të ndaluar hyrjen e njerëzve të cilët rrezikohen seriozisht nga qëndrimi afër këtij vendgrumbullimi, si dhe për të ndaluar hyrjen dhe daljen e kafshëve.
- Të fillojë procedurat ligjore për mbylljen e vendgrumbullimit, duke respektuar kriteret ligjore të përcaktuara në VKM nr.452, datë 11.07.2012, "*Për lëndfillet e mbetjeve*"

Me respekt

Kwrkuesit